

# Buletini mujor

26/01/2023

Oda Ekonomike e Kosovës,  
Nëna Terezë, 10000 Prishtinë  
[www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org), [info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org),  
038 224 299

## PËRMBAJTJA

### 1. Pasqyrë e Ekonomisë

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike.

OEK-u është organizatë profesionale, e pavarur, jopolitike dhe jo-fitimprurëse. Është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlidhjen me partner ndërkombëtar, analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Ka shtrirje në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës.

## 1. Pasqyrë e Ekonomisë së Kosovës


Bruto Produkti Vendor (BPV) në tremujorin e tretë (TM3) të vitit 2022 shënon rritje reale për 3,26% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor 4,31%, Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe

furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 7,18%; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 2,18%; Aktivitete të pasurive të paluajtshme 1,38%.

Aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor janë: Ndërtimtaria (7,78%); Administrata publike, sigurimi social, arsimi dhe shëndetësia (0,48%). Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë:

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve 6,24%; Importi i mallrave dhe shërbimeve 2,98%; Shpenzimet e konsumit final 3,41%. Ndërsa rënie kishte Formimi i bruto kapitalit (2,33%)<sup>1</sup>

Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



<sup>1</sup> Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM3 2022 |

## Statistikat tregtare për muajin Dhjetor 2022


Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për një deficit tregtar më të lartë për 13.8% në muajin dhjetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021, gjegjësisht në vlerë prej 449.4 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 394.9 milion Eurosh në vitin 2021. Eksporti mbulon importin me 13.8%.

Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2022 kishte vlerën 72.0 milion Euro, ndërsa importi 521.5 milion Euro, që është një rritje prej 10.8% për eksport dhe 13.4% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 20.2% e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 16.5% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 12.9% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 11.4% e përbëjnë produktet minerale; 9.8% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5.5% e


### Qarkullimi i mallrave në tregëtinë e jashtme

#### EKSPORTI



### Qarkullimi i mallrave në tregëtinë e jashtme

#### IMPORTI



përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tekstili; 5.4% e përbëjnë makineria, pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.<sup>2</sup>

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 17.8% e përbëjnë produktet minerale; 12.9% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.9% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10.0% e përbëjnë mjetet e transportit; 8.4% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 6.2% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5.0% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.<sup>3</sup>



<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës -Statistikat e Tregtisë së Jashtme(Eksporti), Dhjetor 2022

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës -Statistikat e Tregtisë së Jashtme(Importi), Dhjetor 2022

### Tregtia e jashtme e mallrave me 27 vendet e BE-së

**Eksportet e Kosovës** në vendet e BE-së arritën në 19.1 milion Euro, ose rreth 26.5% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 10.9%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (9.2%), Italia (4.5%), Holanda (3.2%), etj.<sup>4</sup>

**Importet e Kosovës** nga vendet e BE-së ishin rreth 217.2 milion Euro, ose 41.7% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 3.2%. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (12.6%), Italia (5.4%), Greqia (3.9%), Sllovenia (3.8%), etj.<sup>5</sup>




<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti sipas vendeve të BE-së), Dhjetor 2022


<sup>5</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Importi sipas vendeve të BE-së), Dhjetor 2022

## Tregtia me vendet e CEFTA-së

Në muajin dhjetor 2022, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 29.6 milion Euro, ose 41.2% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 29.8%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (16.6%), Shqipëria (13.4%), Serbia (5.4), dhe Mali i Zi (4.7%).<sup>6</sup>




Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s në muajin dhjetor 2022, arritën në 92.7 milion Euro, ose 17.8% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 16.7%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (5.8%), Shqipëria (5.5%), dhe Maqedonia e Veriut (4.9%).<sup>7</sup>




<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovosovës-Tregtia e Jashtme e mallrave (Eksporti me vendet e CEFTA-s), Dhjetor 2022

<sup>7</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovosovës-Tregtia e Jashtme e mallrave (Importii me vendet e CEFTA-s), Dhjetor 2022

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 23.2 milion Euro, ose 32.3%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: SHBA (15.7%) dhe Zvicra (8.2%).



Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 211.5 milion Euro, ose 40.6%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (18.2%) dhe Kina (9.3%).<sup>8</sup>



<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës –Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti dhe Importi me vendet e tjera të botës ,Dhjetor 2022


## Inflacioni mujor dhe vjetor

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.9% në muajin dhjetor 2022.


Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: shërbime për transport (15.9%); energji elektrike (7.6%); veshje (4.2%); blerje të automjeteve (4.0%); qumësht, djathë dhe vezë (2.5%); perime (2.3%); duhan (1.7%); mobile dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (1.3%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.2%); me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1.4% në IHÇK.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 12.1% në muajin dhjetor 2022, krahasuar me muajin dhjetor 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: shërbime për transport (46.9%); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, palet (38.8%); vajra dhe yndyra (30.9%); qumësht, djathë dhe vezë (27.8%); bukë dhe drithëra (21.1%); mish (20.3%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë

NDRYSHIMET MUJORE TE CMIMEVE PER 2022



NDRYSHIMET VJETORE TE CMIMEVE PER 2022



(19.5%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (18.2%); prodhime ushqimore(16.6%); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (16.1%); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (14.4%); energji elektrike (11.9%); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (10.4%); shërbime hoteliere (10.1%); kujdes personal (10.0%); kafe, çaj dhe kakao (9.1%); mobile dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera (8.4%); pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (8.4%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (8.0%); pije alkoolike (7.9%); gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshte dhe manare (7.1%); gjëra personale (7.0%); pemë (6.6%); perime (6.6%); veshje (5.9%); blerje e automjeteve (5.5%); pajisje shtëpiake (4.9%); duhan (4.0%); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (3.8%); dhe produkte farmaceutike (3.1%); me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 11.6 për qind në IHÇK



## Numri i ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM4 - 2022


Në TM4 2022 krahasuar me tremujorin paraprak (TM3 2022) kemi rënje për 3.15% të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2021) kemi rritje për 9.10 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 645 (24.5%), Ndërtimtari me 322 (12.2%), Prodhim me 262 (9.9%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 254 (9.6%), Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 232 (8.8%) etj.


Në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2,543 ndërmarrje të regjistruara në këtë tremujor (96.5 %), me 5 deri 9 të punësuar janë 59 sosh (2.2%), 10 deri në 19 të punësuar 22 (0.8%), 20 deri 249 të punësuar me 12 (0.5%) ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar nuk kemi ndërmarrje gjatë këtij tremujori.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave ashtu si në çdo tremujorë mbizotëron komuna e Prishtinës me 809 ndërmarrje të regjistruara (30.7%), Ferizaj me 233 (8.8%), Prizreni me 178 (6.8%), Peja 142 (5.4%), Gjilani me 130 (4.9%), dhe Gjakova me 113 (4.3%), ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas tremujoreve



Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas viteve



<b>Norma efektive të interesit në bankat komerciale (për muajin Dhjetor 2022)<sup>9</sup></b>	
<b>Norma në kredi<sup>^</sup></b>	<b>6.3%</b>
<i><b>për ekonomitë familjare</b></i>	<b>5.9%</b>
prej të cilave konsumuese	6.4%
prej të cilave hipotekare	5.1%
<i><b>për ndërmarrje</b></i>	<b>6.5%</b>
prej të cilave bujqësore	7.6%
prej të cilave industriale	6.5%
prej të cilave shërbyese	6.4%
<b>Norma në depozita<sup>^^</sup></b>	<b>2.4%</b>
<i><b>të ekonomive familjare</b></i>	<b>1.8%</b>
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.1%
prej të cilave të afatizuara	1.8%
<i><b>të ndërmarrjeve</b></i>	<b>2.5%</b>
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.2%
prej të cilave të afatizuara	2.5%
<b>Dallimi i normës Kredi – Depozita</b>	<b>3.9 pp</b>
<sup>^</sup> mesatare e peshuar e normave të interesit për kreditë e reja	
<sup>^^</sup> mesatare e peshuar e normave të interesit në depozitat e reja	

<sup>9</sup> Banka Qendrore e Kosovës – Informatat mujore të sistemit financiar, dhjetor 2022

## Njësitë rajonale të Odës Ekonomike të Kosovës nëpër Kosovë

### ***Njësia Rajonale Pejë:***

Personi kontaktues: z. Samir Lleshi  
Rr. Çarshia e gjatë -  
Qendra tregtare Burma kati.2, 30000 Pejë  
Tel: 045/ 560 - 999  
email: [samir.lleshi@oek-kcc.org](mailto:samir.lleshi@oek-kcc.org)

### ***Njësia Rajonale Mitrovicë:***

Personi kontaktues: z. Besart Kostanica  
Rr. Mbretëresha Teutë, p.n. 40010 Mitrovicë  
Tel: 045/ 619 - 519  
email: [Besart.kostanica@oek-kcc.org](mailto:Besart.kostanica@oek-kcc.org)

### ***Njësia Rajonale Gjilan:***

Personi kontaktues: z. Ibrahim Tahiri  
Rr. Abdullah Tahiri, p.n. 60000 Gjilan  
Tel: 045/ 699 692  
email: [ibrahim.tahiri@oek-kcc.org](mailto:ibrahim.tahiri@oek-kcc.org)

### ***Njësia Rajonale Ferizaj:***

Personi kontaktues: z. Lulzim Azemi  
Rr. Dëshmorët e Kombit, nr. 144, 70000 Ferizaj  
Tel: 045/ 580 - 666  
email: [lulzim.azemi@oek-kcc.org](mailto:lulzim.azemi@oek-kcc.org)

### ***Njësia Rajonale Prizren:***

Personi kontaktues: z. Armend Hyseni  
Rr. Remzi Ademi, nr. 27, 20000 Prizren  
Tel: 049/ 709 - 657  
email: [armend-hyseni@hotmail.com](mailto:armend-hyseni@hotmail.com)

## Referencat

Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARBK) – Statistikat e tregtisë së jashtme dhjetor 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Repertori statistikor mbi ndermarrjet ekonomike në Kosovë TM4 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit dhjetor 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit TM3 2022

Banka Qendrore e Kosovës – Sistemi financiar dhjetor 2022

***Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik***

*Buletini Ekonomik Mujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë për tremujorin raportues. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.*